

Pas konsensusit politik ndërmjet faktorit vendor dhe atij ndërkombëtar për themelimin e Gjykatës speciale për krime lufte, Kuvendi i Kosovës pritet të përballet edhe me një kompromis të ri, që ka të bëjë me vazhdimin e ulëseve të rezervuara për komunitetet pakicë.

Vazhdimi i këtyre mandateve është kushtëzuar nga minoritetet me votën e tyre për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në [Forcat e Armatosura të Kosovës](#).

Formimi i Forcave të Armatosura si edhe vazhdimi i ulëseve të rezervuara për pakicat dikton nevojën e ndryshimeve kushtetuese. Andaj, as njëra dhe as tjetra, konsiderohet se nuk mund të miratohen si vendime pa votat e dy të tretave të deputetëve dhe votat e shumicës së partive minoritare në Kuvend.

Kryeministri **Hashim Thaçi** këtë javë në disa raste ka bërë thirrje për fleksibilitet politik, që nënkupton një kompromis ndërmjet partive shumicë dhe atyre minoritare.

“Është e nevojshme dhe e domosdoshme që Kryesia e Kuvendit, pa dallim politik, të vë në rend dite votimin në Kuvend formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës”, ka thënë Thaçi.

Një thirrje të veçantë, kryeministri Thaçi ka drejtuar kah Lidhja Demokratike e Kosovës, si partia më e madhe opozitare në Kuvend. Pa votat e këtij subjekti politik nuk do të mund të arrihet kompromisi për vazhdimin e vendeve të rezervuara si një parakusht për themelimin e Forcave të Armatosura.

Deputeti i LDK-së, **Arben Gashi**, thotë se këto dy çështje nuk kanë pse të ndërliqhen mes vete. Kështu që sipas tij, nuk mund të pritet që LDK-ja të bëjë një kompromis të tillë.

Ndërsa, kundërshton vazhdimin e vendeve të rezervuara, Gashi mbështet themelimin e FAK-ut, por pa kushtëzime.

“Thaçi nuk duhet të insistojë në vendet e rezervuara, por të insistojë në mbrojtjen e interesave të Kosovës, e interesi i Kosovës nuk është vazhdimi i vendeve të rezervuara. Ne e kemi FSK-në dhe ka pak rëndësi nëse ia ndërrojmë apo jo emrin. FSK-ja mund t'i kryejë të gjitha operacionet që do t'i kryente edhe FAK-u”, thotë Gashi.

Kundër vazhdimin të ulëseve të rezervuara është shprehur nga fillimi i debateve për këtë çështje edhe Lëvizja Vetëvendosje. Përderisa subjekti tjetër opozitar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është treguar më fleksibile në këtë rast.

Deputeti i AAK-së, **Burim Ramadani**, thotë se është më lehtë për Kosovën që t'i themelojë [Forcat e Armatosura](#) në gjatë këtij mandati të institucioneve.

“AAK-ja e ka shprehur nga fillimi qëndrimin e qartë. Ne duhet të jemi gjeneroz në pikëpamjet për komunitetet tjera. Por, kjo është në duart e partive politike që të reflektojnë”, konsideron Ramadani.

Formimi i Forcave të Armatosura të Kosovës pritet të prezantohet në Kuvend nga Qeveria përmes projektligjit që përcakton ndryshimet e nevojshme ligjore, të cilat do të diktojnë edhe

nevojën e ndryshimeve kushtetuese.

Por, në bazë të paralajmërimeve nga partitë e minoriteteve, deputetët shumicë do të duhet të lëshojnë pe fillimisht në lidhje me vazhdimin e 20 ulëseve të rezervuara në Kuvend, në shkëmbim të votës së tyre, e cila në këtë rast do të jetë e domosdoshme dhe vendimtare për themelimin e FAK-ut./rel/